

Data: 02.04.2023

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: ***“Supervizion punimesh Zgjerimi i rruges Elbasan-
Qafe- Thane (Faza II)”***

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): **71247000-1**
“Mbikqyrja e punës së ndërtimit”

VLERA E FONDIT LIMIT: **20,616,201.04** *(njëzet milion e gjashtëqind e gjashtëmbëdhjetë mijë
e dyqind e një presje zero katër) Lekë, pa TVSH.*

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Autoriteti Rrugor Shqiptar ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 5.

b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas shtojcës 12.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Sipas Shtojces 12

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik",

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare.2019,2020,2021, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e vleres se parashikuar te kontrates (vlera e fondit limit)

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Lloji i procedure është "Sherbim Konsulence", përcaktimi i vleres se kerkuar eshte bere ne mbeshtetje te nenin 43, pika 2, germa "c" të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" ku përcaktohet se: " 40% të vlerës së parashikuar të kontratës në procedurat e prokurimit..... dhe ne procedurat e prokurimit "Shërbim Konsulence" si dhe në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet forms elektronike", si dhe në Udhëzimin e Ministrisë të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar,

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar eshte bere ne mbeshtetje te nenin 43, pika 1 " të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" ku përcaktohet se: " Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare".

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2019, 2020, 2021 (Bilancet të paraqiten konform parashikimit të nenit 41 shkronja c) të Ligjit nr. 1009/2009), **ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.**

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së fondit të limitit të kësaj kontrate

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

***Në rastin e procedurave të prokurimit “Shërbim konsulence”, si përvojë e mëparshme për shërbimet e ngjashme me objektin e prokurimit do të njihen dhe/ose shërbimet e ngjashme me fushat përkatëse të ekspertizës, pjesë e objektit të prokurimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 3 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencë të vlefshme **për mbikëqyrje** të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë sipas përcaktimit në *vendimin nr.759, datë 12.11.2014 të Këshillit të Ministrave, “Për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e koaludimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, ndryshuar me VKM-në nr.943 datë 28.12.2016*”, me kategoritë si më poshtë:

Nr.	Licenca	Kategoria e kryerjes së punimeve
1	NP-1	Punime gërmimi në tokë
2	NP-4	Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvaj, metro, pista aeroportuale
3	NP-5	Punime nëntokësore, ura, vepra arti
4	NP-11	Ndërtime për N/stacionet, kabinat e transformatorëve, linja TN e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë
5	NP-12	Punime inxhinierike mjedisore
6	NS-1	Punime për prishjen e ndërtimeve
7	NS-6	Sinjalistika rrugore jondriçuese
8	NS-7	Barriera dhe mbrojtja rrugore
9	NS-9	Punime strukturore speciale
10	NS-18	Punime topogjeodezike
11	NS-20	Shpime gjeologjike-inxhinierike, puse dhe shpime për ujë

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe *vendimin nr.759, datë 12.11.2014 të Këshillit të Ministrave, “Për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të*

ushetrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikqyrjes e koaludimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, ndryshuar me VKM-në nr.943 datë 28.12.2016” (shënim-përcaktimi aktin ligjor ose nënligjor specifik dhe nenin përkatës, që parashikon licencimin e subjekteve, në lidhje me veprimtarinë përkatëse për realizimin e shërbimeve objekt kontrate).

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente

*Megjense kemi te bejme me Mbikqyrjen e punimeve ne zbatim argumentojme se Kategorite e mesiperme jane percaktuar ne perputhje me zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventivin e punimeve të zbatimit per Objekti **Zgjerim i rrugës Elbasan -Qafë - Thanë (Faza e II)** gjithashtu keto kategori license bazohen edhe ne projektin/ Specifikimet teknike te punimeve te zbatimit per kete objekt.*

2.3.3. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e shërbimeve objekt kontrate, duhet të disponojë personelin kryesor, si më poshtë:

1. Drejtuesin e projektit, që duhet të jetë inxhinier ndërtimi me licensë dhe me eksperiencë pune në mbikëqyrje i cili mban përgjegjësi për zbatimin e projektit sipas kushteve teknike të zbatimit, miratimin e volumeve të punimeve, çertifikatën e pagesës, mbajtjen, kontrollin dhe miratimin e gjithë dokumentacionit, miratimin e ndryshimeve të volumeve, korespondencën me ARSSH.

2. Mbikqyrës për strukturat dhe materiale që duhet të jetë inxhinier ndërtimi/strukturist me licensë dhe me eksperiencë pune në këtë fushë, i cili miraton materialet dhe cilësinë e tyre, si dhe ndjek e miraton cilësinë e punimeve nga pikpamja strukturore, të gjithë veprat e artit në këtë objekt..

3. Mbikqyrësin për punimet topografike, që duhet të jetë inxhinier topograf/ gjeodet me licensë dhe me eksperiencë pune në këtë fushë, i cili kontrollon dhe miraton volumet, piketimet dhe kuotëzimin e objektit.

4. Mbikqyrësin (gjeolog), duhet të jetë inxhinier gjeolog me licensë dhe me eksperiencë pune në këtë fushë i cili kontrollon bazamentin e punimeve të mbushjes, skarpatat e punimet gjatë gërmimit, hapjet dhe thellësinë e themeleve të verpave të artit.

5. Mbikqyrësin për punimet e sinjalistikës, që duhet të jetë inxhinier mekanik me licensë dhe me eksperiencë pune në këtë fushë, i cili miraton materialet dhe cilësinë e tyre dhe ndjek e miraton cilësinë e punimeve të sinjalistikës horizontale e vertikale, (të përkohshme dhe të përhershme) si dhe sigurinë rrugore, gjatë kryerjes së punimeve dhe pas tyre.

6. Mbikqyrësin për punimet e drenazhimit dhe mbrojtjes lumore, që duhet të jetë inxhinier hidroteknik me licensë dhe me eksperiencë pune në këtë fushë, i cili ndjek e miraton cilësinë e punimeve për drenazhimit e trupit dhe skarpatave të rrugës, veprave të vogla hidroteknike si dhe mbrojtjen lumore.

7. Mbikqyrësin për punimet elektrike dhe rrjetin inxhinierik elektrik, që duhet të jetë inxhinier me licensë dhe me eksperiencë pune në këtë fushë.

8. Mbikqyrësin për punimet e mjedisit, që duhet të jetë inxhinier mjedisi me licensë dhe me eksperiencë pune në këtë fushë..

Kriteri konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 12. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese, **si më poshtë:** Për secilin pjestar të stafit kryesor të mesiperm duhet të paraqesë, Kontrate pune e vlefshme, diplome , Libreze pune , CV, si dhe licencat profesionale për mbikqyrje për objektin që prokurohet.

Shenim: Për efekt të vleresimit me pike operatorët mund të ngarkojnë në fazën e parë ose të dytë dokumentacionin e kërkuar lidhur me piken 2.3.3.

****Në rastin e procedurës së prokurimit “Shërbim konsulence”, stafi i angazhuar të paraqesë deklaratë disponueshmërie për kryerjen e shërbimeve që ka marrë përsipër të realizojë.***

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht:

Njesia e prokurimit për vendosjen e stafit i është referuar Termave të referencës, gjithashtu argumentojmë se zgjedhja e stafit të mbikqyrjes është bazuar në punimet respektive të përfshira në projekt preventivin e objektit: ***Supervizion Punimesh Zgjerim i rrugës Elbasan -Qafë - Thanë (Faza e II)***

2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kësaj kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore minimalisht **10 persona** për periudhën **Shtator 2022 - Shkurt 2023**. Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin, **si më poshtë:**

Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet Shoqërore ose Administrata Tatimore sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj, për periudhën **Shtator 2022 - Shkurt 2023**.

Listë pagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën **Shtator 2022 - Shkurt 2023**

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Numri i përcaktuar i punonjësve është përllogaritur si më poshtë: **per percaktimin e fuqise punëtore minimale te kerkuar argumentojme se jemi bazuar ne sherbimet e kerkuara sipas Termave te references, ne preventivin “Supervizion punimesh ne Objektin : Supervizion Punimesh Zgjerim i rrugës Elbasan -Qafë - Thanë (Faza e II).** Si dhe mjetet e kërkuar për zbatimin e kësaj kontrate. *Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë me kohështrirje Shtator 2022 - Shkurt 2023, tregon besueshmëri për autoritetin. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë çdo dëshmi me këtë kohështrirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve dhe përvojën e tyre, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Punësimi i një numri të caktuar, si një nga kërkesat themelore të kualifikimit, përveç besueshmërisë së operatorëve ekonomik, përpiqet të kufizojë edhe problematikat sociale dhe shmangien e informalitetit në tregun e punës, po ashtu është një tregues i kualifikimit dhe eksperiencës që duhet të ketë kjo kategori e punonjësve.*

2.3.5. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

Automjet, copë 1, në pronësi ose me qira,

Pajisje GPS Rover 1 cope në pronësi ose me qira

Pajisje Total Station 1 cope në pronësi ose me qira

Kriteri konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 12. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese, **si më poshtë:**

Per automjetet kur jane ne pronesi te paraqetet çertifikata e pronësisë, siguracioni, çertifikata e kontrollit teknik. Per automjetet me qera te paraqitet kontrata noteriale e qerases me afat deri ne realizimin e plote te kontrates, siguracioni i automjetit, çertifikata e kontrollit teknik.

Per pajisjet duhet te paraqese fature tatimore te shitblerjes ose kontrate qeraje te noterizuar.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të

dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

2.4 Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

2.4.1 Operatori/et ekonomik duhet të paraqesin çertifikatat e cilësisë së punimeve, të vlefshme (ose ekuivalente) për objektin që prokurohet, si me poshte

ISO 9001:2015 Sistemet e Menaxhimit të Cilësisë

ISO 14001:2015 Sistemet e Menaxhimit Mjedisor

ISO 45001 Menaxhimi i Shëndetit dhe Sigurisë në Punë

Të gjitha çertifikatat e mësipërme duhet të jenë të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë çertifikatën e mësipërme sipas zërave të punimeve që do të realizojë.

Argumentimi: *Kerkesat e mesiperme jane vendosur bazuar ne Nenin 79, pika 1 te Ligjit Nr. 162/2020, "Per prokurimin publik", sipas te cilit: "Autoriteti ose enti kontraktor per te vertetuar se punet, mallrat ose sherbimet, objekt prokurimi, i plotesojne kerkesat e cilesise, mund t'u kerkoje ofertuesve te paraqesin certifikata te leshuara nga nje organ i vleresimit te konformitetit, i akredituar nga organizmi kombetar i akreditimit ose organizma nderkombetarë akreditues, te njohur nga Republika e Shqipërisë", si dhe ne zbatim te Neni 44, pika 1 dhe pika 3 te VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", ku përcaktohet se: "Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit"*

Çertifikatat e cilesise jane bazuar ne perputhje me objektin e zbatimit qe do te mbikqyret dhe jane ne perputhje me natyren dhe objektin e kontrates qe prokurohet.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për shërbimet objekt prokurimi, që do të përfshihen në termat e referencës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët "ose ekuivalenti i tij/saj".

Specifikimet teknike të përfshira në termat e referencës janë hartuar në mbështetje të dispozitave të Ligjit Nr.8402 datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", i ndryshuar, Udhëzimit të Këshillit të Ministrave nr. 3 date 15.02.2001 "Për mbikqyrjen dhe

kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Udhëzimit nr.2 datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve te ndërtimit”.